



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim / Direkcija za Obrazovanje / Department of Education

Nr. 182/2024

Datë: 24.04.2024

Në bazë të nenit 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, nenit 62 paragrafi 62.3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimit Administrativ (MFTP) Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.34/2014 Funksionimi i Shërbimit Pedagogjik-Psikologjik në shkolla, Drejtoria e Arsimit, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Nr	Niveli	Pozita	Vend i lirë	Numri i pozitave
1	Shfmu “Shotë Galica”“Runik Shfmu “Faik Dragaj” Leçinë Shfmu “ Migjeni “ Klladernicë	Pedagog/e	Kohë të pacaktuar	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë – nr 13);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, **duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;**
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (**nëse ka**).

II. Kriteret e kualifikimit për pedagog/e

- Niveli Master në Degën e Pedagogjisë të Fakultetit Filozofik, përkatësisht Fakultetin e Edukimit,
- Sistemi katërvjeçar në degën e Pedagogjisë (apo siç është e rregulluar me UA 2014 për licencimin e mësimdhënësve apo bashkpunëtorve professional).

III. Detyrat dhe përgjegjësitë për vendin e punës Pedagog:

- Planifikimin, programin dhe organizimin e punës edukative – arsimore
- Mbështetjen e hartimit dhe zbatimit të planit zhvillimor të shkollës
- Koordinimin e punës së aktiveve personale, planprogramin e mësimdhënësve
- Përkrahjen e klubeve të nxënësve, këshillat e prindërve dhe organet apo këshillat e tjera të shkollës
- Merrë pjesë në hulumtimin e nevojave arsimore, në hartimin dhe zbatimin e projekteve shkollore
- Përcjellë dhe inkurajon futjen e risive dhe praktikave të mira pedagogjike
- Pedagogu vepron në realizim të efektshëm të procesit edukativo-arsimor
- Pedagogu ndihmon dhe udhëzon mësimdhënësit në zbatimin e metodologjive ndërvepruese të mësimdhënies duke promovuar filozofinë me nxënësin në qendër përmes ndihmës për implementimin e nxënies në bashkëpunim me mësimdhënësit duke i ndihmuar ata në përgatitjen e modeleve arsimore, planeve ditore dhe aspekteve të tjera të veprimtarisë arsimore.

IV. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur **30 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **25.04.2024** deri më datën **24.05.2024**.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e komunës, kati i parë, sporteli Nr.13;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Nëse aplikohet për dy pozita, kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta;
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Rezultatet e konkursit do të shpallen në webfaqe të Komunës së Skenderajt.

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Kandidatët me kualifikime jo-përkatëse sipas ligjeve dhe UA të cekur në pikën II të këtij konkursi nuk do të merren në shqyrtim;

- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kritereve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri në 100 pikë apo 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Vlerësimi në intervistimin me gojë bazohet në këto kritere: Njohuritë e përgjithshme 25 pikë; Aftësitë e përgjithshme dhe personalitetit 35 pikë; Njohuritë profesionale 40 pikë;
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mblidhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhen në pozitat e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave publikohen në webfaqen e <https://kk.rks.gov.net/skenderaj/category/konkursey-njoftimet//> (konkurset) dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në web-faqen zyrtare të Komunës të Skenderajt;

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.